ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT PRISHTINA SH.A.

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**70433736-24-3103-5-1-1**
Nr i brendshëm	**KRUP-24-016-5-2-1**

Sa i përket tenderit për: Ndërtimi i rezervoarit per ujë të pijshëm në Bardh i Madh, Grabovc e Mesbardh si dhe ujësjellësit ne fshatrat Orllan, Turiçicë, Kalaticë dhe Herticë, pjesa Lot 2.

ANKESË

1. **Identifikimi i ankuesit***

DIAMANTI SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. "Naim Frashëri" Nr-16

(Adresa)

Prishtinë *10000*

(Vendi) ***(Kodi postar)***

+38344776839

(Numri Telefonit) ***(Numri i Faks-it)***

Azem Tahiraj

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

shpkdiamanti@gmail.com

(Adresa elektronike)

16.09.2024

(Data e parashtrimit të ankesës) ***(Nënshkrimi dhe vula)***

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____ _____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____
(Adresa elektronike)

_____ _____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

1.Njoftimi për kontratë është publikuar me datë: 05.04.2024 2.Data e hapjes së ofertave: 16.05.2024 3.Njoftimi mbi vendimin e AK-së:02.09.2024 4.Kërkesa për rishqyrtim:05.09.2024 5.Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim:09.09.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik
Vendimi i PSH-së nr.2024/0562 i dt.26.08.2024.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

Me dt. 02.09.2024 përmes platformës elektronike e-prokurimi jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku për Lot 2 është rekomanduar për kontratë Grupi i OE **3D ProCon SH.P.K; Petrit Islami B.I**, ndërsa neve na është dërguar letra standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin:

Pjesa/Lot 2
Komisioni i rivlerësimit/KV, pas kryerjes dhe analizimit te ofertave, ka ardhur ne përfundimet si ne vijim:
Konsideroheni i papërgjegjshëm pasi qe keni mospërputhje mes çmimit ne përshkrimin e çmimeve dhe çmimit ne formularin e tenderit.

Rregullorja 001/2022, neni 40.10, pika b) thotë: Ne rast se ka mospërputhje mes çmimit total në Formularin e Tenderit dhe totalit në Përshkrim të çmimeve, oferta refuzohet.
Mbi këtë baze, KV ju konsideron OE te papërgjegjshëm.

Fillimisht ju njoftojmë se në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, ishte nxjerr njoftimi mbi vendimin e AK-së me dt. 11.06.2024, ku edhe në këtë vendim ishte rekomanduar për kontratë grupi i OE 3D ProCon SH.P.K; Petrit Islami B.I, ndërsa neve na ishte dërguar letra standarde për tenderues të pasuksesshëm. Kundër vendimit të lartcekur ne kishim parashtruar kërkesë për rishqyrtim, e më pastaj edhe ankesë në OSHP. Në lidhje me ankesën tonë, paneli shqyrtues i OSHP-së me dt.26.08.2024 ka publikuar vendimin e saj me nr.2024/0562, ku e ka aprovuar ankesën tonë si të bazuar dhe ka detyruar autoritetin kontraktues që të kthej lëndën në rivlerësim.

Tani pas rivlerësimit autoriteti kontraktues edhe pse në vendimin fillestar të saj na kishte shpallur si tenderues të pasuksesshëm tani na ka eliminuar me arsyetimin e lartcekur.

Në lidhje me arsyen e eliminimit të AK-së për kompaninë tonë, ju sqarojmë se gjatë ofertimit ka ndodhur një lëshim teknik nga ana jonë ku tek përshkrimi i çmimeve është vendosur çmimi 128,775.69 €, ndërsa tek formulari i tenderit figuron çmimi 128,755.69 €
Ky lëshim teknik duhet të konsiderohet si devijim i vogël sipas nenit 59.4 pika (ii) sepse nuk ndryshon në substancë asgjë dhe nuk ndryshohen as kushtet e kontratës, sidomos kur kem parasysh faktin se ne jemi OE i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit dhe gjithashtu kur kemi parasysh se sa i nevojshëm është ndërtimi i këtij rezervuari.
Po ashtu ndryshimi i çmimit nuk përbën gabime aritmetike mbi 2 %, kështu që oferta jonë është e përgjegjshme dhe duhet të shpallemi fitues të kësaj kontrate.

Më poshtë po i parashtrojmë pretendimet tona ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, i cili është i papërgjegjshëm:

Edhe pse me vendimin e lartcekur të OSHP-së, është vërtetuar se OE tani i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, autoriteti kontraktues përsëri e ka rekomanduar për kontratë të njëjtin OE dhe me këtë rast ka bërës shkelje ligjore dhe shkelje të rëndë të nenit 97 të Rregullores Nr.001//2022 Për Prokurim Publik. Normalisht për këto shkelje duhet ti revokohet licenca zyrtarit përgjegjës të prokurimit dhe kërkojmë nga OSHP-ja që të iniciojë rastin dhe të kërkojë nga KRPP-ja që ti revokohet licenca.
Pavarësisht që nuk është respektuar vendimi i OSHP-së, ne po i përsërisim edhe njëherë pretendimet ankimore në raport me OE e rekomanduar për kontratë.
OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit, ku është specifikuar *"Kerkesa 3. Se paku nje(1) inxhinier te gjeodezise, si anetar të personelit te vet ose te kontraktuar me marrveshje bashkepunimi, i diplomuar sipas sistemit te para-Bolonjes ose Bolonjes me pervoje se paku 3 vjeçare"*, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar *"Evidenca 3. -Nje kopje te noterizuar te diplomes ose, nese kjo nuk eshte e mundur, nje kopje te diplomes bashk me nje deklarate te pergaditue dhe nenshkruar nga inxhinierit, permes se ciles inxhinieri deklarohet se do jete i angazhuar ne kete projekt-kontrate; -Nje kopje te kontrates valide*

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

te punes apo marrveshje bashkepunimi; dhe -Nje apo disa Letra te references nga nje pale e trete, apo CV-n, per te dëshmuar pervojen 3 vjeçare".

Kur analizohet kërkesa e lartcekur kuptohet qartë se është kërkuar një inxhinier i gjeodezisë i diplomuar sipas sistemit të para Bolonjës ose Bolonjës dhe nga kjo kuptohet se OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit sepse ka prezantuar në ofertë një bachelor të gjeodezisë i cili nuk mund dhe nuk duhet të quhet inxhinier në asnjë mënyrë.
Në lidhje me këtë çështje ne kemi kërkuar sqarime edhe nga Ministria e Arsimit-Divizioni për Njohje dhe Informim akademik, gjë të cilën është dashur ta bëj edhe autoriteti kontraktues, ku kemi parashtruar pyetjen si në vijim:

Te nderuar, ma ane te kesaj shkrese kerkoj nga MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT te na sqaroje ne lidhje me kete kerkese:

Kerkesa : **Inxhinier te gjeodezise i diplomuar sipas sistemit te para-Bolonjes ose Bolonjes.**

Kompania DIAMANTI SHPK kerkone te marre nje sqarim nga MASHTI se a e ploteson kete kerkese Bachelori i gjeodezise i diplomuar ne sistemin e Bolonjes, apo duhet te jete Master i gjodezise, pasi qe ne kerkohet grada Inxhinier i diplomuar.

Ne kemi pranuar përgjigjen nga ana e MASHT si në vijim:

Ne lidhje me pyetjen qe keni parashtuar, bazuar ne Udhezimet Administrative per Krahasueshmerine dhe Barasvleren e Diplomave dhe Programeve Studimore para Sistemit te Bolonjes dhe te Sistemit te Bolonjes, te diplomuarit ne studimet tri dhe katervjeçare, barasvleresohen me 180 ECTS, perkatesisht 240 ECTS, ne nivelin 6 Bachelor. Ndersa te diplomuarit qe kane perfunduar studimet me mbrojtje publike te temes ne fushat teknike te sistemit para Bolonjes dhe kane marre thirrjen Inxhinier i diplomuar, barasvleresohen me graden Master.

Nga sqarimi i lartcekur kuptohet qartë se titulli Bachelor nuk është i barasvlefshëm me titullin inxhinier.
OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar bachelor të gjeodezisë z. Petrit Islamin dhe jo inxhinier të gjeodezisë, ndërsa për ta marr titullin inxhinier duhet të përfundohen studimet në nivelin master, ashtu siç është vërtetuar edhe në sqarimin të cilin e ka dhënë një organ kompetent siç është MASHTI.

Ky pretendim ankimor i yni ka qenë i parashtruar edhe në ankesën me **nr.2024/0562** dhe të njëjtin pretendim paneli shqyrtues i OSHP-së në vendimin e saj me nr.2024/0562 të dt.26.08.2024 e ka aprovuar pretendimin tonë ankimor si të bazuar, duke dhënë arsyetimin si në vijim:
Lidhur me Pretendimi i OE ankues te dyte te parashtruar nga OE ankues sa i përket inxhinierit te Gjeodezisë qe sipas kërkesës 3 të DT-së duke pretenduar se oferta e GOE të rekomanduar përmban një inxhinier të Gjeodezisë sipas sistemit të Bolonjës bachelor, që nuk përkon me kërkesat e DT-së., Paneli Shqyrtues nuk ia fali besimin përgjigjes se dhënë ne raportin e ekspertit pasi qe kërkesa e vendosur ne DT percakton qe inxhinieri te jete i diplomuar ne sistemin e parabolonjes ose sistemin e bolonjes me këtë rast paneli shqyrtues ia fali besimin përgjigjes se dhënë nga MSH e cila parasvlerëson se inxhinier i diplomuar është i barasvlefshëm
me graden master studime te përfunduara ne sistemin e bolonjes , prandaj PSH konstaton se pretendimi ankimor për këtë pike është i bazuar.
Pra paneli shqyrtues i OSHP-së e ka cilësuar pretendimin tonë ankimor si të bazuar dhe në bazë të këtij sqarimi kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe ky fakt është vërtetuar nga një organ kompetent siç është MASHT dhe tanimë edhe nga OSHP.
Edhe përkundër këtij fakti autoriteti kontraktues nuk e ka respektuar vendimin e OSHP-së pasi që ka rekomanduar për kontratë OE të cilin OSHP-ja e ka cilësuar si të papërgjegjshëm dhe me këtë veprim e njëjta ka vepruar edhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

OE i rekomanduar për kontratë po ashtu është i papërgjegjshëm edhe për faktin se i njëjti nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit 11.1- Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik.
OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën në lidhje me krijimin e grupit të operatorëve ekonomik për faktin se në ofertën e të njëjtit përkatësisht në dokumentet e formimit të grupit janë

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

shënuar dy liderë. Tek marrëveshja e themelimit të konsorciumit si lider figuron OE 3D PROCON SHPK, ndërsa tek deklarata e nënshkruar nga secili anëtar figuron si lider OE PETRIT ISLAMI BI, andaj kjo gjë është në kundërshtim me kërkesën e dosjes së tenderit dhe OE i rekomanduar për kontratë është dashur të shpallet i papërgjegjshëm edhe për këtë pikë, sepse nuk mund të specifikohen dy liderë në një tender.

Në lidhje me këtë pretendim ankimor në vendimin e panelit shqyrtues të OSHP-së me nr.2024/0562, është specifikuar si në vijim: "*Paneli shqyrtues në bazë të dokumentacionit te dorëzuar nga GOE i rekomanduar për kontrate konstaton që GOE nuk përmbush kërkesën në DT pika 11.1 (B) edhe pse ne ofertën e GOE të rekomanduar, marrëveshja e themelimit të grupit të konsorciumit përcakton liderin e grupit "3D Procon" SHPK, mirëpo dhe kjo marrëveshje përfshin tri pikat a, b, c sipas nenit 26.2 të Rregullores nr. 01/2022 për Prokurim Publik, mirëpo Deklarata e veçantë mbi përgjegjësitë e veçanta dhe të përbashkëta te grupit është deklaruar si lider i grupit Petrit Islami B.I me këtë deklarim ka rënë në kundërshtim me Deklaratën mbi përgjegjësitë e veçanta dhe te përbashkëta te grupit ku lider këtij grupi është deklaruar përfaqësuesi i OE "3 D PROCON SH.P.K" , Andaj mbi bazën e këtij konstatimi PSH vjen ne përfundim se pretendimi ankimor nga OE ankues është i qëndrueshëm*".

Pra nga sqarimi i lartcekur kuptohet qartë se pretendimi ynë ankimor është i bazuar dhe një gjë të tillë e ka vërtetuar paneli shqyrtues i OSHP-së në vendimin e saj, andaj autoriteti kontraktues është dashur të respektoj vendimin e OSHP-së, mirëpo një gjë të tillë nuk e ka bërë, duke treguar edhe një herë favorizimin që po i bën OE të rekomanduar për kontratë edhe pse i njëjti është i papërgjegjshëm.

Operatorët tjerë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit janë të papërgjegjshëm dhe palë pa interes sepse asnjëri prej tyre nuk kishte parashtruar anesë në OSHP gjatë vlerësimit të parë.

Me dt.09.09.2024 kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.
Në përgjigje fillimisht AK-së ka pretenduar se nuk është shkel asnjë dispozitë e LPP-së, duke përshkruar dispozitat e LPP-së për të cilat kemi pretenduar se janë shkelur. Pra nuk ka arsyetuar fare përse është refuzuar kërkesa për rishqyrtim.

Sa i përket çështjes së ndryshimit të çmimit në paramasë dhe tek formulari i tenderit, ne kemi sqaruar se ky është lëshim teknik i cili nuk ndikon në substancë fare dhe konsiderohet devijim i vogël.

Sa i përket çështjes së inxhinierit te gjeodezisë, AK-së ka theksuar se interpretim të LPP ka kompetencë të bëjë vetëm KRPP, kurse një interpretim jashtë KRPP mund të vie në shprehje vetëm nëse nuk ka interpretim të KRPP-së. AK-së i është referuar një interpretimi të KRPP-së në lidhje me një inxhinier të diplomuar të ndërtimtarisë-hidroteknik dhe ka bashkangjitur interpretimin, mirëpo ne sqarojmë se nuk është kompetente me lëshu interpretime KRPP-ja në lidhje me diplomat e lëshuara dhe barazvlefshmërinë e tyre. Interpretimi nuk lidhet me këtë rast dhe nuk është detyrues për tu zbatuar. Në lidhje me këtë interpretim nuk e dimë si ka qenë kërkesa e dosjes së tenderit, ndërsa në këtë rast është specifikuar qartë kërkesa.
Pavarësisht kësaj MASHT është kompetent për të dhënë përgjigje dhe interpretuar se si fitohen titujt kualifikues universitar duke pasur parasysh ETC kreditë, dhe barazvlefshmërinë e diplomave dhe çështje të tjera.
Në këtë rast MASHT vetëm ka interpretuar dhe sqaruar çështjen e diplomave para dhe gjatë sistemit të Bolonjes, prandaj në këtë rast duhet të merret parasysh ky interpretim i MASHT.
Masht nuk ka bërë interpretim të LPP-së, siç është munduar ta konsiderojë autoriteti kontraktues, prandaj interpretimi dhe sqarimi i MASHT është më kredibil dhe më më kompetencë për këtë çështje, ndërsa për çështje ligjore të LPP-së është kompetent KRPP-ja.

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

Sa i përket konstatimit se gjeodeti është i licencuar tek Agjencia Kadastrale Kosovës, sqarojmë se kjo është çështje tjetër dhe nuk ka të bëjë me çështjen e kualifikimit të kërkuar.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkitazi me ofertën e OE të rekomanduar për kontratë, prandaj duhet rishqyrtuar edhe njëherë ky aktivitet i prokurimit me të gjitha dëshmitë e ofruara.
Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik i papërgjegjshëm.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe specifikimet teknike të detyrueshme, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"*, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.
Kërkojmë nga OSHP-ja që konform nenit 92 të RRPP Nr.001/2022 të parashtrojë kërkesë për revokim të licencës dhe të kërkohet nga KRPP-ja që të veprohet sipas nenit 99 të RRPP Nr.001/2022, sepse mos respektimi i vendimeve të OSHP-së është shkelje e rëndë e përcaktuar në nenin 97 të RRPP Nr.001/2022 .

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga OSHP që të nxjerr:

VENDIM

I. **APROVOHET**, si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **DIAMANTI SH.P.K., për Lot 2**

II. **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

III. **DETYROHET** autoriteti kontraktues të respektoj vendimin e **PSH-së nr.2024/0652 të dt.26.08.2024**

9. Dëmet materiale

"DIAMANTI" SH.P.K DIAMANTI Prishtinë

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale janë të gjitha shpenzimet që janë bërë për të ofertuar dhe tani më parashtrimi i kërkesave për rishqyrtim arrin vlerën prej 10,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

"DIAMANTI" SH.P.K
DIAMANTI
Prishtinë